



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.A.nr.131/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj - kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj- anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizata Joqeveritare Udruženje Gradjana “RESTART” , të paraqitur kundër Vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor nr. 01/2678-2025, të datës 06.10.2025, me të cilin u refuzua kërkesa për akreditim të vëzhguesve për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë: 10.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.131/2025 e datës 06.10.2025 e parashtruar nga Organizata Joqeveritare Udruženje Gradjana “RESTART”, të paraqitur kundër Vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor nr. 01/2678-2025, të datës 06.10.2025, me të cilin u refuzua kërkesa për akreditim të vëzhguesve për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 07.10.2025 PZAP-i ka pranuar ankesën e parashtruar nga organizata joqeveritare Udruženje Gradjana “RESTART” e cila pretendon se me datë 06.10.2025, KQZ ka marrë vendim për refuzimin e akreditimit të 46 vëzhguesve të OJQ UG “RESTART”, me arsyetimin se në statutin e organizatës mungon qëllimi “edukimin e votuesve,të anëtarëve të komisioneve zgjedhore, vëzhguesve të procesit zgjedhor dhe procesit të monitorimit/vëzhgimit të zgjedhjeve”. Sipas vendimit të KQZ të dërguar nga OJQ “RESTART” tutje shtohet se kjo shoqatë ka aplikuar për akreditim për vëzhgim me një Statut i cili është ndryshuar për qëllime të akreditimit për zgjedhje dhe që dallon nga Statuti origjinal me të cilin organizata është regjistruar.

Tutje, parashtruesi i ankesës shton se i pakënaqur me vendimin e marrë, brenda afatit të parashikuar me ligj, paraqet ankesë ndaj këtij vendimi dhe paraqet arsyetimin e mëposhtëm: KQZ e refuzoi kërkesën duke u referuar faktit se neni 3 i Statutit nuk përmban qëllime në lidhje me edukimin e votuesve dhe vëzhgimin e procesit zgjedhor. Megjithatë, me dokumentet e bashkangjitura, ne vërtetojmë se shtesa e nenit 3 të Statutit të OJQ “RESTART” u miratua në mbledhjen e rregullt të Kuvendit, të mbajtur më 20 janar 2025, gjë që dëshmohet nga procesverbali, vendimi dhe ftesa për mbledhje. Me shtesën e nenit 3 të Statutit, është shtuar qartësisht aktiviteti: "Monitorimi i proceseve demokratike (proceset e vendimmarrjes, prokurimet publike, buxhetimi me përgjegjësi gjinore), edukimi i votuesve, anëtarëve të komisioneve zgjedhore, vëzhguesve të procesit zgjedhor dhe procesi i monitorimit/vëzhgimit të procesit

zgjedhor". Në këtë mënyrë, OJQ "RESTART" e ka përputhur plotësisht Statutin e saj me kërkesat ligjore të neneve 54 dhe 57 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Bazuar në këtë kërkesë që PZAP të anulojë vendimin e KQZ-së nr. nr. 01/2678-2025, të datës 06.10.2025 dhe të urdhërojë KQZ-në që të akreditojë 46 vëzhguesit e OJQ "RESTART" për zgjedhjet lokale të 12 tetorit 2025.

Si prova , parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur: Ftesën për mbledhjen e Kuvendit të OJQ "RESTART", të datës 13.01.2025, procesverbalin nga mbledhja e Kuvendit, të datës 20.01.2025, vendimin për shtesën e nenit 3 të Statutit të "OJQ" RESTART, të datës 20.01.2025, teksti i plotësuar i nenit 3 të Statutit.

Në përgjigjen në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), sqaron gjithë ecurinë e procesit të zhvilluar nga ana e saj duke theksuar se është në përputhje me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, më saktësisht paragrafi 1 i nenit 54 ku theksohet se: "Subjektet politike të certifikuara, OJQ-të dhe organizatat qeveritare e ndërqeveritare, sikurse edhe organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilat merren më zgjedhjet dhe mbrojtën e të drejtave të njeriut, përfaqësuesit e vendeve të huaja kanë të drejtë të kërkojnë akreditim të vëzhguesve për zgjedhje. Në kategorinë e organizatave joqeveritare vendore me rastin e aplikimit për akreditim, në përputhje me Regulloren 08/2024 Vëzhguesit e Zgjedhjeve, kërkojnë dokumentet si: formularin e aplikimit për akreditim të OJQ të plotësuar me të gjitha të dhënat e kërkuara; Listën e vëzhguesve të plotësuar me të gjitha të dhënat e kërkuara; Çertifikatën e regjistrimit të OJQ dhe Statutin e OJQ. Të gjitha këto dokumente verifikohen nga Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike e cila më pas rekomandon KQZ për ose kundër akreditimit të OJQ që ka aplikuar.

OJQ UG "RESTART" ka aplikuar përmes platformës elektronike për akreditim të dyzet e gjashtë (46) vëzhguesve për vëzhgimin e Zgjedhjeve Lokale që do të mbahen me 12 Tetor 2025. Sipas dokumentacionit të ngarkuar në platformë, kjo organizatë është regjistruar si OJQ me datën 31 Janar 2016. Në Statutin e tyre tek neni 3, në mes tjerash përfshinë edhe edukimin e votuesve, anëtarëve të komisioneve zgjedhore ,vëzhguesve të procesit zgjedhor dhe procesit të monitorimit/vëzhgimit të zgjedhjeve. Në takim të KQZ-së është kërkuar nga Zyra për verifikim i detajuar i organizatave joqeveritare që kanë aplikuar për akreditim në Zgjedhjet Lokale 2025. Zyra ka kontaktuar Departamentin e OJQ në kuadër të MPB-së në lidhje me dokumentacionet e kësaj organizate të cilat janë deponuara në këtë departament . Tutje në përgjigje theksohet se pas pranimit të materialeve nga DOJQ , Zyra ka vlerësuar dokumentacionin dhe ka vërejtur që sipas statutit të dorëzuar në Departamentin e OJQ në MPB , organizata nuk ka fushëveprim të drejtat e njeriut dhe zgjedhjet . Ndërsa në Statutin që e ka dërguar me rastin e aplikimit për akreditim që mban datën 21 Janar 2025 , në fushëveprim ka edukimin e votuesve , të anëtarëve e të komisioneve zgjedhore , vëzhguesve të procesit zgjedhor dhe procesit të monitorimit/vëzhgimit të zgjedhjeve. Sipas KQZ-së nga shkresat e pranuar nga Departamenti për OJQ , për këtë organizatë nuk ekziston statuti i datës 21.01.2025 dhe sipas kësaj nëse organizata ndërron qëllim dhe fushëveprim, obligohet ta njoftoj Departamentin e OJQ-së brenda afatit prej tridhjetë(30) ditësh nga dita e ndryshimit , lidhur me çdo ndryshim të dhënave , siç përcaktohet me nenin 29 të Ligjit për OJQ. Nisur nga kjo, KQZ –ja , Zyra për Verifikim ka vlerësuar se Statuti i organizatës i dorëzuar në rastin e aplikimit për akreditim nuk është legjitim. Nisur nga çfarë u tha më lartë, Zyra ka rekomanduar KQZ-në për refuzimin e

akreditimit të dyzet e gjashtë (46) vëzhguesve të OJQ UG “RESTART”. Si provë në përgjigje në ankesë ka bashkangjitur: Statuti i OJQ UG “RESTART” i dorëzuar me rastin e aplikimit për akreditim dhe dosjen e OJQ UG “RESTART” e pranuar nga DOJQ/MPB.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë të KQZ gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Paneli vlerëson se, në bazë të shkresave të lëndës rezulton se OJQ UG RESTART”, për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, ka përfunduar aplikimin për akreditim të vëzhguesve si OJQ në Zyrën për Regjistrim, Çertifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ. Ndërsa Zyra për Regjistrim, Çertifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ, me datë 06.10.2025 ka nxjerr rekomandim, përmes të cilit refuzohet aplikimi për akreditim i OJQ UG “RESTART për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025.

KQZ-ja, në mbledhjen e mbajtur me datë 06.10.2025, duke vendosur sipas rekomandimit të Zyrës për Regjistrim, Çertifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ e ka miratuar rekomandimin e Zyrës, për mos aprovim për akreditimin e vëzhguesve të OJQ UG “RESTART. Përkatësisht, KQZ me vendimin e datës 06.10.2025, ka konstatuar se OJQ vendore UG “RESTART” ka aplikuar për akreditim për vëzhgim me një statut i cili është ndryshuar për qëllime të akreditimit për zgjedhje dhe që dallon nga statuti origjinal me të cilin organizata është regjistruar, si rezultat bazuar në nenin 54 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës OJQ UG “RESTART” nuk i ka plotësuar kërkesat ligjore për tu akredituar për vëzhgim të zgjedhjeve.

Paneli, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, qëndrimin dhe përfundimin e KQZ-së, të përshkruar si në vendimin e tij të datës 06.10.2025 me numër protokoll nr. 01/2678-2025, pranon si të drejtë dhe të ligjshëm, pasi që i njëjti është në përputhje me dispozitat ligjore që i referohen vëzhguesit e zgjedhjeve, më konkretisht neneve 54 dhe 55 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregullore Zgjedhore Nr.08/2025 Vëzhguesit e Zgjedhjeve të KQZ-së të cilat përcaktojnë dispozitat e përgjithshme dhe kualifikimi i vëzhguesve që marrin pjesë në zgjedhje.

Paneli rikujton se, në këtë rast KQZ ka konstatuar se nuk akreditohet për vëzhgues mbi arsyetimin se e njëjta ka aplikuar për akreditim për vëzhgim me një statut i cili është ndryshuar dhe që dallon nga Statuti origjinal me të cilin organizata është regjistruar mirëpo nuk është deklaruar në Departamentin e OJQ në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës.

Me dispozitën e nenit 54 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, parashihet që: *“Subjektet politike të certifikuara, OJQ-të dhe organizatat qeveritare e ndërqeveritare, sikurse edhe organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilat merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfaqësuesit e vendeve të huaja, kanë të drejtë të kërkojnë akreditim të vëzhguesve për zgjedhje.”* Po ashtu edhe në Rregulloren Zgjedhore Nr.08/2025 Vëzhguesit e Zgjedhjeve, të KQZ-së, përkatësisht në nenin 2, paragrafi 1,

nënparagrafi 1.1 shprehimisht parashihet që: *“1. Subjektet politike të certifikuara, organizatat jo qeveritare (OJQ), organizatat qeveritare e ndërqeveritare, organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilat merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe përfaqësuesit e vendeve të huaja, kanë të drejtë të aplikojnë për akreditim të vëzhguesve për zgjedhje. 1.1. OJQ që në fushëveprimin e tyre merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut mund të vëzhgojnë procesin zgjedhor”.*

Në rastin konkret Paneli vlerëson se OJQ UG “RESTART” ka aplikuar për të marrë pjesë në zgjedhjet lokale të 12 Tetorit 2025, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat ligjore nga neni 54 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe neni 2 i Rregullore Zgjedhore Nr.08/2025 të KQZ-së, ndërsa Zyra për Regjistrim, Çertifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ ka rekomanduar mos akreditimin për vëzhgues të OJQ UG “RESTART”. PZAP konsideron se vlerësimi për mos akreditim të OJQ-së, për shkak se e njëjta ka ndryshuar qëllimin e statutit me datë 21.01.2025, dhe e njëjta ka qënë e obliguar ta njoftoj departamentin për çdo ndryshim, siç përcaktohet me nenin 29 të Ligjit Nr.06/L-043 për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare i cili parasheh në paragrafin 1. ku thuhet se OJQ informon Departamentin brenda afatit prej tridhjetë (30) ditë nga dita e ndryshimit, lidhur me çdo ndryshim që pësojnë informatat si në vijim: 1.1. emrin e plotë, shkurtësën e OJQ-së; 1.2. adresën e OJQ-së; 1.3. qëllimin dhe fushë-veprimtarinë e OJQ-së; 1.4. emrin, adresën dhe informatat tjera kontaktuese të përfaqësuesit të autorizuar të OJQ-së. 2. Ndryshimet që i pranon Departamenti mbahen, regjistrohen dhe vihen në dispozicion të publikut sipas dispozitave të përcaktuara në këtë ligj.

Nese organizata ndërron qëllimin dhe fushëveprimin, obligohet ta njoftoj Departamentin OJQ-ja brenda afatit tridhjetë(30) ditësh nga dita e ndryshimit, lidhur me çdo ndryshim të dhënave, siç përcaktohet me nenin 29 të Ligjit për OJQ, është i bazuar. Pasi, duke u bazuar në kriteret ligjore që janë përcaktuar me nenet 54, 55 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregulloren Rregullore Zgjedhore Nr.08/2025 të KQZ-së, rrjedh se OJQ me ndryshimin e statuti të saj me 21.01.2025 nuk ka plotësuar kushtet ligjore për akreditim të vëzhguesve.

PZAP vlerëson se vendimi i KQZ-së përmban bazë për refuzim të akreditimit për vëzhgues, në pikëpamje të kushteve ligjore të cilat duhet t'i plotësoj një organizatë joqeveritare vendore, përkatësisht të ketë vlerësim në pikëpamje të kushteve dhe kriterëve ligjore që nga mekanizmi i brendshëm i KQZ është vlerësuar se në këtë rast nuk janë plotësuar për verifikim të vëzhguesve të OJQ UG “RESTART”. Paneli vlerëson se arsyetimi i KQZ-së është i plotë dhe janë paraqitur të gjitha çështjet dhe faktet vendimtare që kane të bëjnë me këtë çështje administrative, sa i përket refuzimit të kërkesës për vëzhguesit e zgjedhjeve të OJQ UG “RESTART. Vendimi i kontestuar përmban një vlerësim të fakteve në raport me dispozitat ligjore, andaj ky vendim është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se është marrë me respektimin e dispozitave ligjore të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregullores 08/2024 për vëzhguesit e zgjedhjeve.

Paneli vlerëson se nga dispozitat e lartcekura, rezulton se vendimi i KQZ-së është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, për çka u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi, konform dispozitës se nenit 54, 55 dhe nenit 118 par. 1 dhe 5 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.131/2025, datë: 10.10.2025

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi